



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO
067 DL 12.01.2020
PRISHTINË • PRISTINA • PRISTINA

VENDIM I BORDIT I DATËS 16.01.2020

Në bazë të konkluzioneve të mbledhjes së Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) të datës 14.01.2020 dhe pas takimit të organizuar ndërmjet Bordit të FBK-së dhe Bordit të Shoqatës së Gjyqtarëve të Basketbollit të Kosovës (SHGJBK) më 15.01.2020, Bordi i FBK-së ka marr Vendim si në vijim:

- 1) Pagesat e muajit Dhjetor 2019 të bëhen më 17 Janar 2020;
- 2) Pagesat e muajit Nëntor 2019 të bëhen më së largu deri më 31 Mars 2020;
- 3) Taksa për gjyqtarët e Superligës së Meshkujve për klubet të mbetet e njëjta pra 80,00 (tetëdhjetë) Euro, ndërsa FBK do ta shtojë shumën 20,00 (njëzetë) Euro në emër të shpenzimeve të udhëtimit dhe shujtës dhe në total do të arrijë shifra 100,00 (njëqind) Euro për Superligën e Meshkujve;
- 4) Pagesat e personave zyrtarë të ndeshjeve të bëhen më së largu deri më 15 të çdo muaji, siç i bie 15 Shkurt, 15 Mars e tutje, 15 Prill, 15 Maj 2020;
- 5) Bordi i FBK-së do të merr përgjegjësi për realizimin e të gjitha pikave të lartpërmendura, si dhe në rast të mos kryerjes së pagesës deri më datën 15 të çdo muaji, Komesarët e Garave nuk do të kenë të drejtë ta bëjnë delegimin për xhiron e radhës deri në kryerjen e obligimeve;

Elvira DUSHKU
Sekretarë e Përgjithshme



Arben FETAHU

Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës

ëëë.basketbolli.com

